

GARRY KASPAROV

dhe

MIG GRINGARD

JETA SI NJË LOJË SHAHU

BOTIMET TOENA

JETA SI NJË LOJË SHAHU

nga

GARRY KASPAROV

dhe

MIG GRINGARD

Përktheu nga anglishtja

Eduard Shalsi

BOTIMET TOENA

Tiranë

Autori: Garry Kasparov (Geri Kasparov) dhe Mig Gringard
Titulli në original: How life imitates chess

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore e Shtëpisë Botuese: Sonila Kapo
Redaktore: Lira Muça
Korrektore letrare: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928376824

© në origjinal Garry Kasparov
© në shqip Botimet Toena
© e përkthimit Eduard Shalsi

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj
mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
Email: botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al>

Nënës sime, për frymëzimin dhe mbështetjen pa fund.

PËRMBAJTA

HYRJE

Sekreti i suksesit 13

Harta e mendjes 15

PJESA I

1: MËSIMI

Mësime personale nga kampioni i botës 21

Të bëhesh i vetëdijshëm për procesin 23

2: JETA IMITON SHAHUN

Shahu shkon në Hollivud 27

Personazhe shahu joimagjinare 29

Prejardhja e lojës mbretërore 30

Sport, art apo shkencë? Sport, art DHE shkencë 31

Më tepër se një metaforë 33

3: STRATEGJIA

Suksesi me çdolloj shpejtësie 37

E ardhmja e vendimeve që merrni në të tashmen 40

Qëndrueshmëria nuk bie në kundërshti me përshtatshmërinë 41

Luaj lojën tënde 43

Nuk mund ta përcaktosh gjithmonë fushëbetëjën 46

Një strategji që ndryshon përherë, është e njëjta gjë

me mungesën e strategjisë 50

Mos u përqendroni më tepër te kundërshtari sesa te vetja 52

Pyetja “Pse?” i kthen njerëzit taktikë në strategji 54

Pasi të keni një strategji, zbatimi i saj

është një çështje dëshire 55

4: STRATEGJIA DHE TAKTIKAT

- Taktikat duhet të udhëhiqen nga strategjia 63
- Një shembull që po përhapet 64
- Qarku vicioz i telasheve me kohën 67
- Strategjia e mirë mund të dështojë me taktika të këqija 69

5: LLOGARITJA

- Llogaritja duhet të jetë e përqendruar dhe e disiplinuar 78
- Imaginata, llogaritja dhe loja ime më e madhe 80
- Njeri plus makinë është kombinim më i fortë se secili veçmas 81

6: TALENTI

- “Kur isha njëmbëdhjetë vjeç, thjesht u bëra lojtar i mirë.” 87
- Njohja e prirjeve në jetën tonë 89
- Fuqia e fantazisë 92
- Fantazia mund të qartësojë mjegullën 94
- Të zhvillosh zakonin e të imagjinuarit 96
- Të pyesësh “Po sikur...?” 97
- Jini të vetëdijshëm për rutinat tuaja, më pas thyejini ato 98

7: PËRGATITJA

- Rezultatet janë ato që kanë rëndësi 104
- Frymëzimi kundrejt punës me djersë 105
- Përgatitja të shpërblen në shumë mënyra 107
- Shndërrimi i një loje në shkencë 109
- Nxitja e vetes për efikasitet 111

PJESA II

8: MATERIALI, KOHA, CILËSIA

- Vlerësimi i kalon llogaritjes 115
- Materiali, elementi thelbësor 116
- Koha është para 119
- Nëse të dy lojtarët janë të lumtur,
a mund të kenë të drejtë të dy? 121

Faktorët afatgjatë kundrejt faktorëve dinamikë	124
Vënia në veprim e elementeve	126
Çfarë ka të keqe një oficer i keq?	127
Kompensimi dhe vlera relative	129
Vlerësim i dyskajshëm	131
Kthimi personal i investimit	132
Perceptimi i cilësisë është cilësia	134
Materiali, koha, cilësia, në frontin e shtëpisë	136

9: SHKËMBIMET DHE ÇEKUILIBRAT

Ngjirja e lojës	141
Kërkimi për kompensim	143
Ligjet e termodinamikës, të shahut dhe të cilësisë së jetës	145
Strategjia në fushëbetejën kompjuterike	146
Të gjitha ndryshimet kanë një kosto	148
Tejzgjatja e shtrirjes sonë	145
Faktorët statikë dhe zgjedhja e të këqijave tona	149

10: RISIA

Originaliteti është një punë e vështirë	158
Të rrisim treguesin tonë të rrisë	159
Fuqia e rrisë	160
Zbutja e një tigri	162
Vetëm risia nuk mund të garantojë suksesin	164
Kalimi nga imitues në novator	166
Risitë e evolucionit	168
Të dimë se çfarë nënkuptojnë shpikjet	169
Dhe një fëmijë do të na udhëheqë	171
Kompjuterë që zhvillojnë një lojë njerëzore	173
Idetë pasqyrojnë shoqërinë	173
Frika nga ndryshimi është më e keqe se ndryshimi shumë i shpejtë	177
Guximi për të hequr dorë	180

11: FAZAT E LOJËS

- Të dimë pse e kryejmë çdo lëvizje që bëjmë 184
- Përmirësimi i produktit 188
- Arti lind nga konflikti krijues 188
- Sigurohuni që një paqe e mirë të pasojë një luftë të mirë 191
- Eliminimi i paragjytimeve të fazave 193
- Mos e jani me thikë në një përplasje me armë 194

12: PROCESI I VENDIMMARRJES

- Zhvillimi i një skeptiku 200
- Procesi kundrejt përmbajtjes 202
- Sa informacion është informacion i tepërt? 203
- Lëvizjet kandidatë dhe krasitja e pemës së vendimit 206
- Vënia në punë e intuitës 207

13: PËRPARËSIA E SULMUESIT

- Nxitja e zjarreve konkurruese 215
- Nisma rrallëherë thërret dy herë 217
- Një sulmues me zgjedhje 219
- Kërcënimi është më i fortë se ekzekutimi 221
- Një fjalë për mbrojtjen 222
- Rrezikimi i suksesit 223
- Guximi ka magji 225

PJESA III

14: TË VËSH NË PIKËPYETJE SUKSESIN

- Suksesi është armiku i suksesit të ardhshëm 231
- Pesha e suksesit të kaluar 231
- Konkurrenca dhe taktikat kundër vetëkënaqësisë 233
- Zbulimi dhe ndreqja e të metave 236

15: LOJA E BRENDSHME

Loja mund të fitohet para se të ulesh në tryezën e shahut	242
Stuhia para qetësisë	243
Nëse doni t'ju marrin seriozisht, merreni veten seriozisht	245
Mos u hutoni ndërsa përpiqeni të shpërqendroni të tjerët	248
Rëndësia e marrjes së kontrollit	250
Prishja e magjisë së trysnisë	251
Të qëndrosh objektiv në situata të vështira	252
Kur më e mira e mundshme nuk mjafton	254
Pretendentët për kurorën dhe të metat fatale	256

16: BURRË, GRUA, MAKINERI

Të kundërshtojmë veten	263
Dallimi mes të qenët më mirë dhe më ndryshe	266
Krijimi i një stili universal	268
Është madhështia e lindur, apo e kultivuar?	270
Hyrja e makinerive	273
Nëse nuk mund t'i mposhtni, bashkohuni me ta	274
Qëndrimi larg “zonës së komfortit”	277
Shahu kompjuterik	280

17: TABLOJA E MADHE

Duhet të shohim të gjithë fushën	285
Bërja e lidhjeve	286
Përparësitë dhe disavantazhet e specializimit	288
Të menduarit global dhe lufta globale	289
Loja në gjithë fushën	292
<i>Ndeshja</i> në Rusi sot	297

18: INTUITA

Ne dimë më shumë nga sa kuptojmë	300
Intuita kundër analizës	301
Sa kohë është kohë e mjaftueshme?	304
Rreziqet e shpërfilljes së një prirjeje	306

19: PIKA E KRIZËS

Kriza në Sevilje, një rast studimi	311
Dallimi i një krize, përpara se të bëhet krizë	312
Strategjia për fitore të domosdoshme	314
Ndërlikim, degëzime, turbullira dhe rreziqe	316
Gabime në të dyja anët	320
Nxjerrja e mësimit nga një krizë	323
Mbajtja e titullit	326

EPILOG

Jeta është mënyra se si përgatitesh për të	329
Jo më të fshehta	330

EPILOG SHITESË

Një strategji për demokracinë	333
-------------------------------	-----

FJALOR 339

HYRJE

Sekreti i suksesit

Si një yll adoleshent i shahut në Bashkimin Sovjetik të çmendur pas shahut, u mësova me intervistat dhe fjalimet publike, që në një moshë shumë të re. Përveç pyetjeve të rastit për argëtimet dhe vajzat, këto intervista të hershme përqendroheshin vetëm në karrierën time të shahut. Më pas, në vitin 1985, në moshën njëzetedyvjeçare, u bëra kampioni më i ri i shahut në histori dhe që atëherë, ndryshoi edhe natyra e pyetjeve. Në vend të lojërave dhe turneve, tashmë njerëzit donin të dinin se si kisha arritur një sukses kaq të jashtëzakonshëm. Si isha kaq i përkushtuar pas punës? Sa lëvizje mund të parashikoja? Çfarë mendoja gjatë lojës? A zotëroja një kujtesë fotografike? Çfarë ushqimesh haja? Çfarë bëja çdo natë para se të flija? Shkurt pra, cilat ishin sekretet e suksesit tim?

Shpejt kuptova se publiku zhgënjehej nga përgjigjet e mia. Punoja shumë sepse kështu më kishte mësuar nëna. Fakti se sa lëvizje mund të parashikoja, varej nga pozicionet e gurëve në fushë. Gjatë lojës, përpiquesha të vija në zbatim ato që kisha mësuar dhe llogarisja variacionet. Kujtesa ime ishte e mirë, por jo fotografike. Zakonisht, para çdo loje, haja një drekë të rëndë, me salmon të tymosur, bërçollë dhe ujë tonik. (Fatkeqësisht, nga fundi i të tridhjetave, trajneri personal më këshilloi që ta braktisja këtë dietë njëherë e mirë.) Çdo natë, para se të flija, laja dhëmbët. Të gjitha këto nuk janë aspak veprime që të ndjellin frymëzim.

Të gjithë, me sa dukej, prisnin të dëgjonin nga unë një metodë të saktë, një recetë të plotë që mund ta ndiqnin edhe vetë për të arritur rezultate. Shkrimtarët e famshëm i pyesin se çfarë lloj letre dhe stilolapsi përdorin, a thua se shkrimi varet nga gjëra të tilla. Këto lloj pyetjesh anashkalojnë faktin se ne të gjithë jemi të veçantë, jemi rezultati i miliona elementeve dhe transformimeve që rrjedhin nga ADN-ja jonë. Ne të gjithë krijojmë formulën tonë unike për të

marrë vendime. Qëllimi ynë është që ta shfrytëzojmë sa më mirë këtë formulë, ta përcaktojmë, të vlerësojmë performancën e saj dhe të gjejmë mënyra për ta përmirësuar.

Ky libër përshkruan se si ka evoluar formula ime, si e shihja procesin gjatë asaj kohe, dhe si e shoh tani, që mund të jap një gjykim më të mirë. Gjatë librit, do të përmend një numër të madh njerëzish që kanë kontribuar në zhvillimin e formulës sime, si drejtpërdrejt, ashtu edhe tërthorazi. Tek unë kanë ndikuar lojërat frymëzuese të Aleksandër Alekhinit, heroit tim të parë të shahut, por edhe personalitete si Uinston Çerçilli, librat e të cilit më kanë lënë një mbresë të thellë, dhe vazhdoj t'i lexoj.

Shpresoj se nga këta dhe shembuj të tjerë, edhe ju do të arrini të mësoni se si të zhvilloni dhe të përmirësoni aftësitë tuaja si vendimmarrës. Kjo gjë do të kërkojë që të jeni të sinqertë në vlerësimin e vetvetes dhe faktit se sa e keni përmbushur potencialin tuaj. Nuk mund të ketë korrigjime të shpejta dhe ky nuk është një libër me këshilla dhe marifete. Ai flet për vetëndërgjegjësimin dhe sfidën dhe si mund ta nxisni veten dhe të tjerët, për të mësuar se si të merrni vendimet më të mira.

U frymëzova për të shkruar këtë libër kur kuptova se, në vend që të vrisja mendjen për të dhënë përgjigje të goditura kur më pyesnin: “Çfarë je duke menduar?”, do të ishte më interesante po ta zbuloja vetë të vërtetën. Por jeta e një profesionisti shahu, me axhendën e zënë, të mbushur me udhëtime, lojëra dhe përgatitje, nuk më lejonte të kisha shumë kohë për reflektime filozofike, dhe duhej të përqendrohesha më tepër në anën praktike. Kur e lashë shahun profesionist në mars të vitit 2005, më në fund, zotëroja kohën dhe perspektivën e nevojshme për të reflektuar mbi përvojat e mia dhe për t'i ndarë ato me të tjerët, në një mënyrë sa më të dobishme.

E dija se ky libër do të ishte shumë më ndryshe nëse do ta kisha përfunduar përpara zhvendosjes time dramatike nga fusha e shahut, në atë politike. Në fillim, më nevojitej kohë për të përthithur të gjitha mësimet që më kishte dhënë shahu. Së dyti, përvojat e mia të reja, po më detyrojnë që të reflektoj mbi faktin se kush jam dhe cilat janë aftësitë e mia. Të kesh pasion për të qenë një përkrahës publik i demokracisë, nuk mjafton. Për të ndërtuar koalicione dhe për të organizuar konferenca, mua më duhet të vë në zbatim vizionin strategjik dhe aftësi të tjera të shahut, në mënyra krejt të ndryshme.

Pasi kam kaluar njëzet e pesë vjet në një zonë komforti, tani duhet të analizoj aftësitë e mia për të ndërtuar dhe rindërtuar veten për këto sfida të reja.

Harta e mendjes

Ditën kur mbusha gjashtë vjeç, u zgjova dhe zbulova dhuratën më të bukur që kisha marrë ndonjëherë për ditëlindje. Pranë shtratit tim, ndodhej një glob i stërmadh. Fërkova sytë për t'u siguruar që nuk po shihja ëndërr me sy hapur! Gjithmonë më kishin magjepsur hartat dhe gjeografia, dhe historitë e mia të parapëlqyera të kohës së fëmijërisë, ishin rrëfimet e tim atit për udhëtimet e Marko Polos, Kolombit dhe Magelanit. Gjithçka filloi kur babai më lexoi librin e Stefan Cvajgut, “Pushtuesi i Deteve: Historia e Magelanit”. Që atëherë, ai më rrëfente rregullisht udhëtimet e eksploruesve të mëdhenj nëpër glob.

Shpejt, mësova emrat e të gjitha kryeqyteteve të botës, popullsitë e vendeve dhe çdo gjë të re të ngjashme që dëgjoja. Këto rrëfime të ngjarjeve të vërteta, më magjepsnin më tepër se çdo përrallë. Megjithëse nuk diskutonim mbi vështirësitë e udhëtimit në det në të kaluarën, e merrja me mend se sa i guximshëm duhej të ishte ai njeri që vendosi ta bënte i pari udhëtimin. Histori të tilla frymëzuan shpirtin tim aventurier. Më hipi dëshira të shtegtoja nëpër vende të reja, edhe pse në atë moshë, kjo nënkuptonte thjesht kalimin nga një rrugë e re për t'u kthyer në shtëpi. Edhe gjatë karrierës sime si shahist, kërkoja sfida të reja, gjëra që askush nuk i kishte bërë më parë.

Epoka e eksploruesve dhe e perandorëve të mëdhenj ka kaluar tashmë, por mbeten ende disa territore të çmuara për t'u zbuluar. Ne mund të eksplorojmë vetë kufijtë tanë dhe të jetëve tona. Mund të ndihmojmë edhe të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë, ndoshta duke i dhuruar një fëmije një glob për ditëlindje, apo ekuivalentin digjital të një globi.

Të pasurit e një harte personale është me rëndësi thelbësore dhe ky libër mund të kalojë vetëm përciptazi nëpër fazat e vëzhgimit dhe analizës që nevojiten për hartimin e një harte të tillë. Nuk e zmadhoj kur them se “emëruesi më i vogël i përbashkët” nuk vlen për asgjë. Sepse nuk mund të gjendet asnjë përparësi dhe nuk mund të arrihet asnjë përmirësim në atë çka është identike dhe e përbashkët për të

gjithë. Ne duhet të vështrojmë më lart dhe të gërmojmë më thellë, t'i lëmë pas gjërat bazike dhe universale. Në teori, kushdo mund të mësojë që të luajë shah brenda vetëm gjysmë ore dhe rregullat natyrisht që janë të njëjta për çdo burrë, grua dhe fëmijë. Por kur lëvizim përtej rregullave, pra kur e kalojmë nivelin fillestar në të cilin duam vetëm të kryejmë lëvizje të lejueshme nga rregullat, atëherë fillojmë të krijojmë prirje të reja që na shquajnë nga gjithë të tjerët që lëvizin gurët në fushë.

Prirjet e reja që krijojmë dhe logjika për t'i operuar ato, ndërthuren me cilësitë tona të lindura, për të krijuar një vendimmarrës unik. Përvoja dhe njohuritë kalojnë nëpër prizmin e talentit, i cili në vetvete, mund të nxitet, të venitet ose të kultivohet. Kjo përzierje është edhe burimi i intuitës, një mjet jashtëzakonisht unik për secilin prej nesh. Këtu fillojmë të vëmë re ndikimin e psikologjisë individuale dhe strukturës sonë emocionale, që reflektohen në vendimet tona - një dukuri që në shah quhet stil i lojtarit. Shahu është një instrument i përsosur për të vëzhguar këto ndikime, sepse për të shkëlqyer në këtë lojë, ne jemi të detyruar që të analizojmë vendimet që marrim dhe sesi arrijmë në ato vendime. Kjo ishte e dhëna që u nevojitej në të vërtetë atyre njerëzve që më bënë vazhdimisht pyetje, në vend të informacioneve rreth zakoneve të mia të rëndomta: për të zbuluar këtë është i nevojshëm vetëhetimi.

Ne nuk mund ta zgjedhim dot vetë stilin tonë. Ai nuk është ndonjë softuer i rëndomtë kompjuterik që mund të shkarkohet dhe të instalohet. Ne duhet të përcaktojmë se çfarë funksionon më mirë për ne dhe më pas, nëpërmjet sfidës dhe provës, të zhvillojmë metodën tonë personale. Çfarë më mungon? Cilat janë pikat e mia të forta? Cilave sfidave iu shmangem dhe pse? Metoda e suksesit është e fshehtë sepse mund të zbulohet vetëm duke analizuar vendimet tona. Vendimmarrja më e mirë nuk mund të mësohet nga të tjerët, por mund të mësohet vetë.

Në fillim do të përballemi me një kontradiktë. Ne duhet të bëhemi të ndërgjegjshëm për proceset tona të vendimmarrjes dhe me praktikë, ato do të përmirësojnë edhe performancën tonë intuitive, e cila është e pandërgjegjshme. Kjo sjellje jonatyrle është e nevojshme për shkak se, si të rritur, ne i kemi formuar tashmë prirjet tona, si ato të këqija dhe të mira. Për të korrigjuar të këqijat dhe për të përmirësuar të mirat, duhet të bëhemi më të vetëndërgjegjshëm.

Ky libër përpiket të përdorë anekdota dhe analiza për të hapur dyert ndaj këtij ndërgjegjësimi. Pjesa e parë shqyrton përbërësit thelbësorë, aftësitë themelore që nevojiten në marrjen e një vendimi. Strategjia, llogaritja, përgatitja - duhet t'i kuptojmë këto elemente thelbësore dhe t'i identifikojmë ato te vetja jonë. Pjesa e dytë e librit shqyrton mënyrat që mund të përdorim për të ndërthurur të gjitha këto gjëra që të përmirësojmë performancën tonë. Psikologjia dhe intuïta ndikojnë në çdo aspekt të vendimeve dhe rezultateve tona. Ne duhet të zhvillojmë aftësinë për të parë tablonë më të gjerë, si dhe për t'u përballur me krizat dhe për të nxjerrë mësim prej tyre.

Momente të tilla vendimtare janë pika kyç që do të na nevojiten sa herë që përballemi me një udhëkryq në jetë. Ne jetojmë për momente të tilla dhe ato na përcaktojnë jetët. Mësojmë se kush jemi në të vërtetë dhe se çfarë ka vërtet rëndësi për ne. "Sekreti" është që t'i ndjekim këto sfida në vend që t'u shmangemi atyre. Kjo është e vetmja mënyrë për të zbuluar dhe shfrytëzuar të gjitha dhuntitë tona.

Duke krijuar një model personal, ne mund të marrim vendime më të mira për veten tonë, mund të zhvillojmë besimin për t'u zënë besë instinkteve tona dhe të jemi më të sigurtë se cilido qoftë rezultati, në fund do të bëhemi më të fortë. Ky është sekreti unik i suksesit për secilin prej nesh.

PJESA I

MËSIMI

Mësime personale nga kampioni i botës

Kur luajta për herë të parë në kampionatin e shahut të vitit 1984, isha një sfidues i ri që po përballesha me një kampion, i cili e kishte ruajtur titullin për pothuajse dhjetë vjet. Asokohe, isha njëzet e një vjeç dhe isha ngritur me aq vrull në botën e shahut, sa që nuk mendoja se kjo pengesë do të më priste rrugën. Prandaj u shokova kur pësova katër humbje pa asnjë fitore dhe për dy disfata të tjera, do të kisha provuar poshtërimin e një disfate të plotë.

Kjo ishte koha e përsosur për një ndryshim strategjie. Prandaj, në vend që të bija pre e dëshpërimit, e detyrova veten që të përballesha me një betejë të gjatë e rraskapitëse. E ndryshova taktikën në një “luftë guerile” lojë pas loje, duke pakësuar rrezikun dhe duke pritur për shansin tim. Kundërshtari im, sovjetiku Anatoli Karpovi, ndoqi shembullin tim, për qëllimet e veta. Ai donte t’i jepte një mësim zengjinit të ri, duke shënuar një fitore absolute 6-0, prandaj edhe ai luajti pa rrezikuar, në vend që të përfitonte dhe të hidhej menjëherë në sulm.

Karpovi u frymëzua edhe nga rezultati i paraardhësit të tij, kampionit Bobi Fisher. Gjatë garës në kampionatin e vitit 1972, amerikanin arriti dy fitore absolute 6-0 kundër rivalëve të klasit botëror, pa asnjë barazim. Karpovit mendonte që të arrinte këtë rezultat legjendar, prandaj ndryshoi strategjinë e zakonshme kur u ndesh me mua. Por imitimi i Fisherit doli një gabim serioz.

Plot shtatëmbëdhjetë lojëra u zhvilluan pa asnjë rezultat vendimtar. Këto barazime nuk ishin të kota, por po tregonin se strategjia ime po funksiononte. Ndeshja u zvarrit muaj pas muaji, duke thyer gjithë rekordet për zgjatjen e një kampionati botëror. Ekipi im kalonte aq

shumë kohë duke vrarë mendjen si luante Karpovi dhe çfarë strategjish ndiqte ai, saqë edhe mua po më dukej vetja sikur po bëhesha Karpovi.

Gjatë dyqind orëve lojë dhe përgatitje, pata mundësinë të vëzhgoja edhe stilin e lojës sime dhe mënyrën time të logjikuarit. Deri në atë pikë të karrierës, për mua çdo gjë kishte qenë e thjeshtë, fitorja dukej se ishte bërë rezultati i pritshëm dhe i natyrshëm. Ndërsa tani duhej të përqendrohesha në mënyrën se si i merrja vendimet, që të ndreqja gjërat që nuk shkonin. Kjo po funksiononte, por kur humba në lojën e njëzeteshtatë dhe dola me rezultatin 0-5, dukej se nuk kisha mësuar aq shpejt sa ç'duhej për të shpëtuar ndeshjen. Nëse pësoja edhe një humbje tjetër, do të duhej të prisja edhe tre vjet për të garuar sërish për titullin e kampionit.

Vazhdova të ndiqja taktikën e mbrojtjes, ndërkohë që ishin bërë tre muaj që po ndesheshim. Ndryshimi i stilit ia kishte vështirësuar punët edhe Karpovit. Ndieja se po i afrohesha gjithnjë e më tepër zgjidhjes së enigmës, ndërkohë që kundërshtari im po bëhej gjithnjë e më i tensionuar dhe i lodhur.

Më në fund, ndodhi kthesa. Pasi i mbijetova lojës nr. 31, kur Karpovi nuk arriti të më jepte një goditje vendimtare, unë fitova lojën nr. 32 dhe u hodha në sulm. Më pas u ndeshëm edhe për pesë javë të tjera vetëm me barazime, por ndryshimi ishte se tashmë, po i krijoja vetes më shumë shanse për fitore sesa kundërshtari. Ndërkohë, bota po pyeste veten nëse kjo ndeshje do të kishte ndonjëherë të sosur. Asnjë kampionat nuk kishte zgjatur ndonjëherë më shumë se tre muaj ndërsa ne po hynim në muajin e pestë. Karpovi dukej i rraskapitur dhe unë fillova të ngulmoja më tepër. Pasi iu afrova fitores në lojën nr. 46, fitova lojën nr. 47 në mënyrë marramendëse. Mos kishte qenë ndonjë mrekulli? Pikërisht në atë moment, organizatorët vendosën se lojtarët kishin nevojë për pushim dhe loja e ardhshme u shty për disa ditë. Pavarësisht këtij vendimi të papritur, unë fitova edhe lojën e ardhshme. Papritur, rezultati u ngushtua në 3-5 dhe unë kisha marrë tashmë vrullin.

Më pas, më 15 shkurt 1985, në mënyrë vërtet të çuditshme, presidenti i Federatës Ndërkombëtare të Shahut (FIDE), Florencio Kampomanes, nën tryshninë e autoriteteve sovjetike të sportit, mbajti një konferencë për shtyp, ku deklaroi se ndeshja ishte anuluar. Pas pesë muajsh, dyzet e tetë lojërash dhe mijëra orësh përgatitje dhe studim,

ndeshja përfundoi pa një fitimtar. Ne duhej të ktheheshim prapë pas gjashtë muajsh për t'u ndeshur sërish dhe herën e ardhshme do të vendosej një kufi deri në njëzet e gjashtë lojëra. Karpovi i shpëtoi rrezikut të menjëhershëm dhe mundi ta mbante titullin e kampionit edhe për më gjatë. Deklarata zyrtare për shtyp thoshte se Karpovi “e kishte pranuar” vendimin dhe Kasparovi “i ishte bindur” atij. Një dallim ky, i imët, por tejet domethënës. (Ndërtesa e hotel “Sport”, ku u mbajt konferenca famëkeqe, është prishur që atëherë. Megjithatë, shpirti diktatorial që simbolizon ajo, dhe shumë më tepër Moska, jetojnë ende në kujtesën time.)

Përveç kësaj përvoje të hidhur me politikën dhe shahun sovjetik, mësova edhe shumë gjëra gjatë ndeshjes. Kampioni i botës kishte qenë trajneri im personal për pesë muaj rraskapitës. Jo vetëm që kisha mësuar stilin e tij të lojës, por u kthjellova edhe mbi vetë procesin tim të të menduarit. Po bëhesha gjithnjë e më i aftë për të gjetur gabimet e mia, për të zbuluar se pse i bëra, për të mësuar sesi t'i shmangia dhe si të përmirësoja procesin e vendimmarrjes. Kjo ishte përvoja ime e parë kur mësova të vija veten në pikëpyetje, në vend që të mbështetesha vetëm tek instinktet.

Kur erdhi koha e ndeshjes së dytë në Moskë, tashmë nuk duhej të prisja me muaj të tërë për të arritur fitoren time të parë. Fitova që në lojën e parë. Ndeshja sërish ishte shumë e fortë. Mbeta mbrapa në fazat fillestare, por kësaj radhe, nuk isha më ai naivi njëzetënjëvjeçar. Kisha mbushur boshllëqet që kishte shfrytëzuar Karpovi në fillim të ndeshjes së parë. Si një veteran njëzetëdvjjeçar me gjykim të shëndoshë, u bëra kampion bote dhe e mbajta titullin për plot pesëmbëdhjetë vjet. Kur dola në pension në vitin 2005, isha ende lojtari më i vlerësuar në botë, por për një lojtar shahu, mosha dyzetënjëvjeçare është e moshuar, duke marrë parasysh se shumë nga kundërshtarët e mi ishin adoleshentë.

Të bëhesh i vetëdijshëm për procesin

Për mua nuk do të kishte qenë e mundur të qëndroja në majë për kaq shumë kohë, pa edukimin që më dha Karpovi për lojën dhe dobësitë e mia. Nuk ishte i rëndësishëm vetëm zbulimi i pikave të

dobëta, por edhe që unë t'i gjeja vetë ato. Asokohe, nuk e kuptoja plotësisht, por kjo “ndeshje maratonë” famëkeqe, më tregoi çelësin drejt suksesit. Nuk mjafton që të kesh talent. Nuk mjafton që të punosh fort duke studiuar deri natën vonë. Duhet të bëhesh edhe i vetëdijshëm për metodat që përdor për të marrë vendimet.

Vetëndërgjegjësimi është thelbësor për të qenë i aftë të ndërthurësh njohuritë, përvojën dhe talentin, për të arritur kulmin e performancës tënde. Të paktë janë njerëzit që marrin mundimin për të kryer një analizë të tillë. Çdo vendim rrjedh nga një proces i brendshëm, qoftë në fushën e shahut, në Shtëpinë e Bardhë, në sallat e mbledhjeve, apo në tryezën e kuzhinës. Çështja e vendimeve të tilla ndryshon sipas vendit, por procesi mund të jetë shumë i ngjashëm.

Duke qenë se shahu ka qenë fokusi i jetës sime që në një moshë e hershme, është e natyrshme që unë të prirem për ta parë botën nga prizmi i shahut. Kam vënë re se kur njerëzit vështrojnë gjashtëdhjetë e katër kuadratet e fushës së shahut, ata i japin atij ose respekt të tepërt, ose shumë të pakët. Shahu nuk është ndonjë hob i kotë dhe as ndonjë ushtrim që duhet lënë në dorën e gjenive dhe superkompjuterëve. Për të kuptuar më mirë temat parësore, kapitulli i ardhshëm do të trajtojë me shpejtësi disa nga konceptet dhe keqkuptimet e “lojës mbretërore”.

Anatoli Jevgenieviç Karpovi (1951-), BRSS/Rusi

Kundërshtari që la gjurmë të thellë në jetën time

Kampioni i dymbëdhjetë i botës në shah - 1975-85. Lindur në Zlatoust, BRSS. Pasi u ngrit me shpejtësi në rang, Karpovi u kurorëzua kampion botëror në vitin 1975, kur ish-kampioni amerikan Bobi Fisher humbi titullin e tij pas negociatave të stërzgatura me federatën ndërkombëtare të shahut. Karpovi ndjeu nevojën për të dëshmuar aftësitë e tij pas marrjes së titullit në këtë mënyrë dhe ai fitoi turne pas turne. Ai ende mban rekordin më mbresëlënës se çdo lojtar tjetër në turneun e shahut.

E ka mbrojtur titullin kampion me sukses në vitet 1978 dhe 1981: të dyja herët kundër Viktor Korçnoit. Unë dhe Karpovi luajtëm në pesë kampionate botërore radhazi: 1984, 1985, 1986, 1987, 1990, gjithsej 144 lojëra. Rezultati ynë pas kësaj maratone ishte rrotë më rrotë: njëzet e një fitore për mua, nëntëmbëdhjetë për Karpovin dhe 104 barazime!) Këto ndeshje “KK” konsiderohen gjerësisht si një nga rivalitetet më të forta kokë më kokë në historinë e sportit.

Karpovi fitoi mbështetje të madhe politike në BRSS, në sajë të domosdoshmërisë së perceptuar për të rifituar titullin nga amerikanë Fisher. Ai ishte i lidhur fort me strukturën e pushtetit sovjetik dhe nga natyra, ka qenë gjithmonë i prirë për t’u lidhur me pushtetin. Stilet tona të kundërta të shahut, si zjarri me akullin, pasqyruan gjithashtu reputacionin tonë “bashkëpunëtori përballë rebelit” jashtë fushës së shahut.

Stili i tij i manovrimit të kujdesshëm çoi në krijimin e termit “karpovian” në fjalorin e shahut. Ai i referohet taktikës së eliminimit të kundërshtarit nëpërmjet një sulmi të qetë, që është krahasuar me mënyrën se si një gjarpër piton mbytyt prenë e tij.

Mbi Anatoly Yevgenyevich Karpov-in: “Kundërshtarët i kuptojnë synimet e Karpovit vetëm atëherë kur nuk kanë më shpëtim” - Mikhail Tali

Thënie të Karpov-it: “Le të themi se një lojë mund të vazhdojë në dy mënyra: njëra prej tyre është një goditje e bukur taktike që krijon variacione të cilat nuk u nënshtrohen llogaritjeve të sakta. Tjetra është një pozicion i qartë me trysni ndaj kundërshtarit që çon në një finale me shanse mikroskopike për fitore. Unë do të zgjidhja këtë të fundit pa u menduar dy herë.”

JETA IMITON SHAHUN

Shahu shkon në Hollivud

Vështirë të mendosh imazhe më paradoksale sesa reputacioni i lojës së shahut në kontrast me atë të shahistit. Shahu pranohet si një simbol universal i intelektit dhe kompleksitetit, sofistikimit dhe dinakërisë. E megjithatë, imazhi i shahistit të përkushtuar, është ai i një njeriu ekscentrik, ndoshta edhe psikopat.

Në shumë vende perëndimore, stereotipi i lojtarit të shahut është shpesh sinonim i një ngordhalaqi kockë e lëkurë, ose e një vetmitari me tru, por mizantrop. Këto perceptime për lojtarët vazhdojnë të jenë të përhapura, edhe teksa imazhet pozitive mbi shahun, shfaqen rregullisht nëpër Hollivud dhe “Madison Avenue”.

Kush mund ta harrojë sekuencën hapëse të filmit të Xhejms Bondit, “Nga Rusia me dashuri” (*From Russia with love*), ku zuzari Kronstin fiton një turne shahu, e më pas nis të thurë komplete të liga me pasoja për gjithë globin? Autori i Bondit, Ian Flemingu dhe regjisori i filmit, i kushtuan një vëmendje të veçantë lojës midis Kronstinit dhe kundërshtarit të tij “Mekadams”, duke e bazuar atë në një lojë të vërtetë shahu, midis dy lojtarëve të mëdhenj sovjetikë, kampionit të dhjetë të botës, Boris Spaskit dhe sfiduesit të tij, David Bronstajnit. Historia e filmit e përdor në mënyrë të dukshme shahun si një metaforë, kur një nga bashkëpunëtorët e Bondit, e paralajmëron atë: “Këta rusët janë shahistë të zotë. Kur duan të kryejnë një komplot, e ekzekutojnë atë në mënyrë të shkëlqyer. Loja planifikohet imtësisht, hapat e armikut janë të parashikuar”.

Shumë filma të tjerë e kanë përdorur shahun në mënyrë të ngjashme, për të vënë në dukje mendjemprehtësinë dhe të menduarit

strategjik të protagonistit. Filmi i vitit 1995, “Vrasësit” (*Assassins*), e portretizon Sylvester Stalonen dhe Antonio Banderasin si vrasës profesionistë, të cilët përpiqen të vrasin njëri-tjetrin gjatë ditës, ndërsa luajnë shah në internet gjatë natës. Në filmin e Steinli Kubrikut të vitit 1968, me titull “2001”, kompjuteri HAL 9000, e mposht me lehtësi personazhin Frank Pul në shah, duke i paraprirë faktit se makineria në fund do ta vrasë atë.

Shahistët konsiderohen edhe si krijesa të mbyllura në vetvete, pothuajse obsesivë, madje edhe autikë. Vladimir Nabokovi ishte një entuziast i shahut, por ai nuk e përmirësoi aspak namin e shahistit me romanin e vitit 1930, “Mbrotjtja” (që më vonë mori emrin “Mbrotjtja e Luzhinit”), ku personazhi kryesor është një dijetar i mbyllur në vetvete, i cili është trajnuar nga një mjeshtër i madh i shahut, por që nuk arrin të përshtatet me shoqërinë njerëzore, përtej aftësisë për të luajtur shah. Versioni i filmit në vitin 2000, u përpoq të portretizonte një pamje më të këndshme, duke i dhënë disa ngjyime romantike.

Austriaku Stefan Cvajg gjithashtu ka krijuar personazhe të shahut të cilat janë tepër të çuditshme dhe problematike. Romani i botuar pas vdekjes së autorit, me titull “Loja mbretërore”, është një koment psikologjik dhe politik mbi nazizmin, që përqendrohet në dy lojëra shahu midis një kampioni bote, i cili është pothuajse analfabet, dhe një mjeku, i cili pasi ishte arrestuar nga Gestapo, u çmend në burg, duke luajtur shah me veten, brenda katër mureve të qelisë. Në libër, Cvajgu jep një përshkrim dramatik të lojës së shahut:

Por a nuk është jashtëzakonisht e ngushtë që ta quash shahun një lojë? A nuk është ai një shkencë, një teknikë, një art, që lëkundet midis këtyre kategorive, ashtu si lëkundet arkivoli i Muhamedit midis qiellit dhe tokës, njëherësh një bashkim i të gjitha koncepteve kontradiktore: i lashtë, e megjithatë i ri; mekanik në funksion, por efektiv vetëm përmes imagjinatës; i kufizuar brenda hapësirës gjeometrike, edhe pse i pakufishëm në kombinimet e tij... si vërtetohet nga provat, shahu është më jetëgjatë në qenien dhe praninë e tij, se të gjithë librat dhe arritjet; e vetmja lojë që u përket të gjithë njerëzve dhe të gjitha moshave; askush nuk e njeh

hyjninë që ai i fali botës, për të vrarë mërzinë, për të mprehur shqisat, për të ngazëllyer shpirtin...

Fëmijët mund të mësojnë rregullat e tij të thjeshta, pleqtë e ngathët bien pre e tundimit të tij, por brenda këtij sheshi të ngushtë e të pandryshueshëm, loja krijon një specie të veçantë mjeshtri, që nuk mund të krahasohet me asnjë tjetër - këta janë persona të destinuar vetëm për shah, gjeni të veçantë, vizioni, durimi dhe teknika e të cilëve, funksionojnë përmes një shpërndarjeje jo më pak të saktë se e matematikanëve, e poetëve, e kompozitorëve, duke e bashkuar shahistin me ta, por në një nivel të ndryshëm.

Personazhe shahu joimagjinare

Në fakt është e vërtetë se disa lojtarë të njohur në të kaluarën, kanë pësuar dëme psikologjike, gjatë ose pas karrierës së tyre. Për shembull, “Mjeshtri i madh” gjerman, Kurt von Bardeleben, vrau veten në vitin 1924, njëlloj si bëri Luzhini në librin e Nabokovit, duke u hedhur nga dritarja. Kampioni i parë zyrtar botëror, Vilhelm Steinici, vuajti për një kohë të gjatë nga problemet mendore në vitet e fundit të jetës. Një nga lojtarët më të suksesshëm të çerekut të parë të shekullit XX, Akiba Rubenstajn, ra ngadalë viktimë e ndrojtjes patologjike. Pasi kryente një lëvizje, ai fshihej në qoshe të sallës, duke pritur lëvizjen e kundërshtarit.

Dy lojtarët më të mëdhenj nga Shtetet e Bashkuara, e lanë shahun në kulmin e karrierës dhe vuajtën nga paqëndrueshmëria mendore. Pol Morfi nga Nju-Orlins, mposhti lojtarët më të mëdhenj të botës në turneun europian të viteve 1858-59, dhe më pas e braktisi shahun disa vite më vonë, për të nisur një karrierë të pafrytshme në fushën ligjore. Nuk luajti më kurrë shah serioz dhe në vitet e fundit të jetës, heroi i parë amerikan i shahut, vuajti nga halucinacionet. Shtypi pretendoi se shkak për këtë ishte mendja e tij gjeniale.

Në vitin 1972, Robert (Bobi) Fisher rrëmbeu titullin e kampionit të botës nga Boris Spaski dhe Bashkimi Sovjetik, në një ndeshje legjendare, të mbajtur në Rejkjavik të Islandës. Më pas e braktisi lojën për njëzet vjet, nuk pranoi të mbronte titullin në vitin 1975 dhe u

zhduk për mbi një dekadë. Kur Fisherin më në fund arritën ta bindnin që të luante në një “kampionat” rindeshjeje me Spaskin në vitin 1992, në Jugosllavi (asokohe nën sanksionet e OKB-së), ai jo vetëm që luante një shah të ngathët (si parashikohej pas kaq shumë vitesh), por bëri edhe disa komente të ulëta dhe paranojake antisemite.

Por raste të tilla të veçanta, si nëpër romane ashtu edhe në jetën reale, e bëjnë të lehtë që të harrosh shumicën e lojtarëve të shahut, të cilët nuk kanë asgjë të pazakontë, përveç aftësisë për të luajtur mirë shah.

Prejardhja e lojës mbretërore

Nëse i vetmi shah që keni parë është diagrami në gazetën e mëngjesit, mund të habiteni nga fakti se loja ka një literaturë të gjerë disa qindrvjeçare, madje edhe mijëra, po të përfshijmë variantet mitike të lojës, të cilat mendohet se e kanë origjinën nga India. Një nga librat e parë të prodhuar nga makina e shtypjes e Kakstonit në shekullin XV, ishte “*The Game and Playe of Chess*”. Pesëqind vjet më vonë, disa nga komunikimet e hershme në atë çka më vonë do të quhej internet, përmbanin lëvizjet e një loje shahu midis shkencëtarëve në laboratorët e provave.

Teknika e regjistrimit të lojërave të shahut me simbole (“shënim shahu”) detajon historinë e shahut, duke u mundësuar miliona shahistëve gjatë shekujve, që të shijojnë dhe të mësojnë nga ndeshjet e lojtarëve legjendarë të së kaluarës.

Duke e konsideruar historinë e shahut si një pjesë të vetme, ne mund të vëzhgojmë zhvillimin e qëndrueshëm të lojës. Këtu nuk e kam fjalën për rregullat, të cilat u standardizuan kryesisht në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë. Ndërsa rregullat kanë mbetur të pandryshuara, stili dhe idetë qendrore të lojës kanë ndryshuar në mënyrë dramatike në 150 vitet e fundit, megjithëse në hapa të vegjël evolucionarë.

Pasi shkrova një sërë artikujsh të shkurtër në gazeta mbi kampionët e botës që kishin dalë para meje, u fiksova me idenë për të analizuar në thellësi se si ka ndryshuar loja e shahut gjatë dekadave dhe si zhvillimi i saj është nxitur nga praktikuesit më të mëdhenj. Kisha në mendje

të shkruaja një biografi të vetë shahut, të treguar përmes analizës së kujdesshme të lojërave më të mëdha dhe më me ndikim. Ky projekt, i cili ka zënë një pjesë të madhe të jetës sime për tre vitet e fundit, erdhi në jetë në formën e një serie librash, me titull “Paraardhësit e mi të mëdhenj”.

Tani jemi në pjesën e gjashtë. Gjatë këtij procesi, kam mësuar shumë për lojtarët e mëdhenj të së kaluarës. Çdo kampion bote kishte dhunti individuale dhe kontribuoi jashtëzakonisht në evolucionin e lojës. Studimi i dymbëdhjetë kampionëve të botës që erdhën përpara meje dhe rivalëve të tyre më të mëdhenj, më bëri të pyes veten se çfarë e mundësoi këtë “duzinë të madhe” që të ketë sukses? Çfarë kishin kampionët që u mungonte sfiduesve?

Është e natyrshme që shahistët të argumentojnë se aftësia në shah nënkupton zotërimin e një inteligjence të madhe, madje edhe gjenialiteti. Për fat të keq, nuk ka shumë prova që e mbështesin këtë teori. Dhe nuk është i vërtetë perceptimi i zakonshëm i publikut se shahistët më të mirë janë kompjuterë njerëzorë, të aftë për të mësuar përmendësh megabajt të dhënash dhe për të llogaritur me dhjetëra lëvizje përpara.

Me sa kam vëzhguar unë, në të vërtetë, nuk ka shumë prova që tregojnë se mjeshtërit e shahut zotërojnë talente që shkojnë përtej aftësisë për të luajtur shah. Kjo ka nxitur breza të tërë kërkuesish që të përpiqen të zbulojnë se pse disa njerëz mund të luajnë mirë shah dhe të tjerë jo. Nuk ekziston ndonjë gjen shahu, apo ndonjë prirje e përbashkët në fëmijëri, e megjithatë, ashtu si në fushën e muzikës dhe të matematikës, edhe në shah, ka njerëz me dhunti të jashtëzakonshme. Fëmijë që në moshën katërvjeçare janë bërë yje, duke mundur të rritur vetëm pak muaj pasi e mësojnë shahun duke parë më të rriturit teksa luajnë.

Pra, është e qartë se ekziston një talent në shah, por kjo nuk është shumë e dobishme. Edhe nëse keni fatin dhe zotëroni talentin, ju mund të mos e kuptoni dot kurrë këtë, pa praninë e faktorëve të tjerë, dhe ia vlen të përqendrohemi në faktorët që mund t’i vëzhgojmë më mirë dhe të kemi një ndikim mbi ta.

Sport, art apo shkencë? Sport, art DHE shkencë

Nëse do të pyesnit një mjeshtër të madh shahu, një artist dhe një ekspert kompjuterësh, se çfarë e bën një lojtar shahu të quhet i mirë, atëherë do ta kuptonit se përse kjo lojë është një laborator ideal për procesin e vendimmarrjes. Ka shumë mundësi që një lojtar profesionist i shahut të jetë dakord me kampionin e dytë të botës, gjermanin Emanuel Lasker, i cili thoshte: “Shahu është mbi të gjitha një luftë”. Sipas Laskerit, nuk ka shumë rëndësi si e përcakton shahun, çështja është vetëm si të fitosh.

Artisti Marsel Dyshamp ishte një lojtar i fortë dhe i përkushtuar i shahut. Në një periudhë të caktuar të jetës, ai e braktisi botën e artit për t’u marrë me shah, duke thënë se loja e shahut “zotëron të gjithë bukurinë e artit, madje shumë më tepër se kaq”. Dyshampi e theksonte edhe më tepër këtë aspekt të lojës, duke thënë se: “Unë kam dalë në përfundimin se jo të gjithë artistët janë lojtarë shahu, por të gjithë shahistët janë artistë”. Është e vërtetë se nuk mund të mohohet elementi krijues i shahut, por ai duhet racionalizuar kundrejt objektivit parësor, fitimit të lojës.

Më tej vijmë tek aspekti shkencor, të cilin e theksojnë së tepërmi shumë njerëz që nuk janë lojtarë shahu. Kujtesa, llogaritjet e sakta, dhe përdorimi i logjikës, janë thelbësore. Kur rreth viteve 1950, u shfaqën për herë të parë kompjuterët që luanin shah, shumë shkencëtarë menduan se këto bisha të hekurta, shumë shpejt do të mposhtnin çdo lojtar njerëzor. Dhe sot, pas 50 vjetësh, vazhdon ende beteja për epërsi midis njeriut dhe kompjuterit.

Kampioni i gjashtë i botës, Mihail Botviniku, që ishte edhe mësuesi im, në 30 vitet e fundit, iu përkushtua punës për të krijuar një lojtar shahu kompjuterik. Nuk bëhej fjalë për një kompjuter që mund të luante shah, çka ishte relativisht e lehtë për t’u arritur, dhe në atë periudhë kjo njihej, por për të krijuar një program që të realizonte lëvizje sipas mënyrës njerëzore, pra një lojtar artificial të mirëfilltë.

Botviniku ishte inxhinier dhe i diskutoi idetë e tij me shumë shkencëtarë, përfshirë edhe matematikanin legjendar amerikan Klod Shanon, i cili gjatë kohës së lirë, kishte skicuar dizajnin e një makine shahu. Shumica e programeve të shahut në thelb “kryejnë

thjesht llogaritje numerike”, të cilat në fakt i realizojnë shumë shpejt. Ato përqendrohen në shqyrtimin e hollësishëm të çdo lëvizjeje të mundshme, brenda një intervali kohe të caktuar. Ato vlerësojnë çdo lëvizje me një rezultat të caktuar pikësh dhe pastaj zgjedhin lëvizjen me numrin më të lartë të pikëve. Botviniku donte të shkonte përtej kësaj, duke krijuar një program që të përdorte logjikën në përzgjedhjen e lëvizjeve të shahut, në vend të përlllogaritjeve të ngurta numerike.

Thënë shkurt, projekti i tij dështoi. Vite të tëra pune me paraqitje idesh dhe modelesh teorike, nuk krijuan dot asnjë program që të mund të luante shah më mirë se një lojtar fillestar (ndërsa programet me përlllogaritje numerike filluan të funksionojnë në nivele kompetente që nga vitet 1970). Si mund të arrinte një kompjuter të imitonte aftësinë krijuese dhe intuitën njerëzore? Edhe sot e kësaj dite, 30 vjet më vonë, kompjuterët ende mbështeten në metodën e thjeshtë llogaritëse.

Sidoqoftë, programuesit e shahut kanë filluar të prekin kufijtë e metodave të tilla. Për të përmirësuar performancën e tyre, ata tashmë janë detyruar të shqyrtojnë disa nga idetë e Botvinikut. Megjithëse projekti dështoi, shumë nga idetë e tij ishin të vlefshme dhe i pararendnin kohës. Tani që po kuptohet se përlllogaritjet e ngurta numerike nuk mund ta përmbledhin dot këtë lojë të lashtë, ne po kthehemi sërish te vizioni i Botvinikut, që kërkonte t’iu mësonte programeve të shahut të mendonin si qeniet njerëzore.

Më tepër se një metaforë

Ne e dimë se kompjuterët janë të aftë të kryejnë llogaritje shumë më mirë se ne, atëherë cili është çelësi i suksesit tonë? Përgjigjja është: sinteza, aftësia për të ndërthurur krijimtarinë me llogaritjen dhe artin me shkencën, duke formuar një tërësi shumë më të madhe se shuma e pjesëve përbërëse të saj. Shahu është një lidhje unike konjitive, një vend ku arti dhe shkenca bashkohen në mendjen njerëzore dhe përmirësohen dhe rafinohen me përvojën.

Pikërisht në këtë mënyrë ne arrijmë të përmirësohemi në çdo fushë të jetës që ka të bëjë me të menduarit, pra praktikisht, në çdo

gjë. Një shef ekzekutiv duhet të ndërthurë analizën dhe kërkimin me të menduarit krijues, në mënyrë që të udhëheqë me efikasitet kompaninë e tij. Një gjeneral ushtrie duhet të zbatojë njohuritë e tij mbi natyrën njerëzore, për të parashikuar dhe për t'ju kundërvënë strategjive të armikut.

Gjithashtu, këtu ndihmon fakti se kemi një fjalor të përbashkët pune me këto fusha. Nëse ju ka ndodhur ndonjëherë të dëgjoni rastësisht një bisedë ku përdoren terma si “faza e hapjes”, “dobësi sektoriale”, “planifikim strategjik” dhe zbatim “taktik”, ju mund të hamendësoni se bëhet fjalë për blerjen e ndonjë kompanie. Por ajo mund të jetë edhe një bisedë për një turne shahu në fundjavë.

Natyrisht që termat në fushën e biznesit dhe atë ushtarake janë të pafundmë në krahasim me 64 kuadratet e kufizuara të tabelës së shahut. Por pikërisht falë kësaj fushe të kufizuar veprimi, shahu ofron një model fleksibël për vendimmarrjen. Në shah ka standarde të rrepta të suksesit dhe të dështimit. Nëse vendimet janë të gabuara, pozicioni juaj përkeqësohet dhe lavjerrësi anon nga humbja, nëse vendimet janë të mira, ai anon nga fitorja. Çdo lëvizje në lojë pasqyron një vendim dhe më pas, mund të analizohet me saktësi shkencore nëse çdo vendim ishte apo jo ai më efikas.

Me anë të objektivitetit, ne mund të depërtojmë thellë në proceset e vendimmarrjeve tona duke i analizuar ato. Sigurisht, bursa dhe fushëbeteja janë shumë më të ndërlikuara, por njëlloj si në lojën e shahut, suksesi në to, varet nga cilësia e vendimeve tona dhe këto trajtohen gjatë analizave të metodave krahasuese.

Çfarë e bën dikë një menaxher më të mirë, një shkrimtar më të mirë, apo një shahist më të mirë? Pa dyshim se jo çdo njeri mund të arrijë në të njëjtin nivel apo të zotërojë të njëjtat aftësi për të përparuar drejt suksesit. Ajo çka është e domosdoshme, është që të gjejmë udhën tonë drejt majës, të zhvillojmë talentet tona, të përmirësojmë aftësitë dhe të kërkojmë ato sfida që do të na lejojnë të arrijmë nivelin më të lartë. Dhe për ta bërë këtë, fillimisht na nevojitet një plan.

Mihail Moisejeviç Botvinnik (1911-1995) BRSS / Rusi

Patriarku i palëkundur

Kampioni i gjashtë i botës, 1948-57, 1958-60, 1961-63. Lindi në Kuokala, Rusi. Kur Aleksandër Alekhini vdiq në vitin 1946, duke mbajtur ende titullin e kampionit të botës, u organizua një turne me lojtarët më të mirë për të nxjerrë kampionin e ri. Atë e fitoi Botvinniku, i cili do të ishte i pari nga një listë e gjatë kampionësh bote nga Bashkimi Sovjetik. Ai ishte inxhinier, por gjithnjë e kishte pasur pasion shahun.

Përveç titullit si “patriarku i shahut sovjetik”, Botvinniku njihet edhe si “mbreti i rindeshjeve”. Ai u mund dy herë radhazi në ndeshjet e kampionatit botëror, por një vit më vonë u rikthye dhe e shpartalloi kundërshtarin. Aftësia e tij për të hetuar në thellësi dhe për t’u përgatitur për karakteristikat e kundërshtarëve, krijoi një nivel të ri rreptësie dhe profesionalizmi në shah. Aftësia për t’u rikthyer dhe për të fituar në rindeshje, kërkonte më tepër se thjesht këmbëngulje. Botvinniku ishte i aftë të analizonte me objektivitet lojën dhe të korrigjonte dobësitë që kundërshtari ia kishte shfrytëzuar herën e parë.

Natyra e tij e palëkundur mbeti e tillë deri në fund të jetës. Në vitin 1994, i kërkuam të na nderonte me praninë e tij në një turne shahu *rapid* (të shpejtë) në Moskë. Botvinniku, asokohe 83 vjeç, nuk pranoi, duke thënë: “Shahu *rapid* nuk është serioz!”. Ne i thamë se shahu i shpejtë ishte në modë dhe se në këtë turne po luanin të gjithë, madje edhe rivali i tij i vjetër Vasili Smislovi. Ai u përgjigj: “Unë e kam zakon që mendoj gjithnjë me kokën time dhe nuk më bëhet vonë edhe sikur 100 të tjerë të mendojnë ndryshe!”.

Botvinniku e la shahun profesionist në vitin 1970, për t’u përqendruar në punën si trajner dhe në fushën e re të shahut kompjuterik. Shkolla Botvinnik ftonte për të garuar të rinjtë më të talentuar nga i gjithë vendi, dy-tri herë në vit, dhe ka nxjerrë disa breza kampionësh. Ndër të parët ishte Anatoli Karpovi, në fillimin e viteve 1960. Në vitin 1973, një nga nxënësit e shkollës ishte edhe dhjetëvjeçari Geri Kasparov. Në kohën kur i riu Vladimir Kramnik u regjistrua në vitin 1987, shkolla kishte marrë

tashmë emrin e përbashkët Botvinik-Kasparov - një numër vërtet mbresëlënës kampionësh.

Mbi Botvinnik-un: “Kur të kanosen rreziqe nga çdo anë dhe shpërqendrimi më i vogël mund të rezultojë fatal; në një pozicion ku duhet të kesh nerva prej çeliku dhe përqendrim të jashtëzakonshëm, Botviniku është në habitatin e tij.” - Max Euwe, kampioni i pestë i botës.

Thënie të Botvinnik-ut: “Ndryshimi midis njeriut dhe kafshës është se njeriu është i aftë të caktojë prioritete.”

STRATEGJIA

“Njeriu që di *si*-në, do të ketë gjithmonë një punë, njeriu që gjithashtu di edhe *pse*-në, do të jetë gjithmonë shefi i tij.”

- *Ralph Waldo Emerson*

Suksesi me çdollosj shpejtësie

Futbolli dhe deri diku loja hokej, ishin sportet me spektatorë me të cilët u rrita në Bashkimin Sovjetik. “Loja e bukur” si njihet gjerësisht futbolli, është një nga lojërat më të thjeshta për sa i përket rregullave. Mjafton të shohësh disa ndeshje, dhe e kupton shpejt si luhet loja. Disa miq janë përpjekur të më shpjegojnë futbollin amerikan dhe bejsbollin, gjë që më ka shtyrë të mendoj se pikërisht thjeshtësia e dukshme e futbollit, ka qenë arsyeja pse ai nuk është një sport popullor në ShBA. (Ose si vërehet shpesh, mbase arsyeja ka të bëjë me faktin se futbolli ofron shumë pak mundësi për hapësira reklamash.)

Sado i thjeshtë që është futbolli, strategjitë e lojës janë të thella dhe komplekse. Qëllimi i dukshëm është të shënohen gola dhe njëkohësisht të parandalohet që kundërshtari t’i shënojë ato. Por mënyra më e mirë për ta arritur këtë, është shumë e debatueshme. Për shembull, strategjia tradicionale e ekipit kombëtar italian, është mbrojtja. Sipas kësaj logjike, nëse kundërshtari nuk shënon ndonjëherë gol, ti nuk mund të humbasësh. Të tjerë, si brazilianët, përdorin mjete të kundërta për të arritur të njëjtin qëllim, mposhtjen e kundërshtarit.

Përfytyroni sikur do të mësonit të luanit shah nga një udhëzues, të cilit i mungojnë disa faqe. Ai të mëson si të sistemosh tabelën dhe si të lëvizësh dhe të marrësh gurët e kundërshtarit, por nuk të thotë asgjë mbi qëllimin e lojës, pra si të zësh shah mat kundërshtarin. Dikush që mëson nga një udhëzues i tillë, mund të bëhet i aftë në llogaritje

dhe manovrime, por nuk do të kishte objektiva më madhore. Pa një objektiv, loja e tij do të ishte e pakuptimtë.

Shprehja e vjetër e shahut, “një plan i keq është më i mirë se mungesa e një plani” është mjaft e goditur. Çdo hap, çdo reagim, çdo vendim, duhet të ndërmerret sipas një plani të qartë. Përndryshe, do të merrni vetëm vendimet më të dukshme, por pa qenë të sigurt nëse janë me të vërtetë përfituese. Dhe kjo është edhe më e rëndësishme duke marrë parasysh ritmin e shpejtë me të cilin po përparon bota në ditët e sotme.

Përgjatë përvojës sime 30-vjeçare si lojtar profesionist i shahut, në fillim, ne shahistët duhej të kërkonim me ditë të tëra mbi kundërshtarin, duke rrëmuar nëpër libra të pluhurosur dhe revista, ndërsa tashmë mund të njohim çdo ndeshje që ka zhvilluar kundërshtari gjatë gjithë karrierës së tij, brenda disa sekondave, nëpërmjet një kompjuteri. Njëherë e një kohë, duhej të prisnim me muaj të tërë që ndeshjet e një turneu të botoheshin në revistat përkatëse. Tani çdokush mund t’i ndjekë ato drejtpërdrejt në internet.

Ndikimi i revolucionit informativ shkon përtej komoditetit. Kur të dhënat janë të disponueshme shumë më shpejt, duhet të përshpejtohet edhe aftësia për t’u marrë me këtë informacion. Kur luhet një lojë shahu në Moskë, ajo është e disponueshme për t’u analizuar në të gjithë botën. Një ide që duhej kohë për t’u zhvilluar, mund të imitohet që të nesërmen nga të tjerët, kështu që një lojtar duhet të jetë i vetëdijshëm për këtë dhe të përgatitet.

Ky përshpejtim i ritmit ka ndikuar mbi vetë lojën e shahut. Në vitin 1987, unë luajta 6 ndeshje të shahut *rapid* në skenën e Hipodromit në Londër, kundër anglezit Najxhëll Short, i cili do të më sfidonte për titullin kampion bote, gjashtë vjet më vonë. Ishte ndeshja e parë serioze e këtij lloji, me një ritëm shumë më të përshpejtuar loje. Në këto lojëra të shpejta, secili nga ne kishte vetëm 25 minuta kohë për të kryer të gjitha lëvizjet, shumë më pak se shahu tradicional, ku një lojë mund të zgjasë deri në 7 orë.

Unë u trajnova në mënyrë intensive me këto kufizime kohore dhe zbulova se ishte ende e mundur të luaja me koncepte të thella, pavarësisht pamundësisë për të llogaritur në mënyrë të thellë

çdo lëvizje. Në vend që të studiojmë thellë çdo pozicion, duhet të mbështetemi më tepër tek instinktët. Do të ishte e drejtë të thuhej se në shahun *rapid*, planifikimi i kujdesshëm dhe objektivat strategjike duhet të jenë dytësore, apo edhe duhen shpërfillur, dhe duhet përqendruar më tepër në llogaritjen e shpejtë dhe intuitën. Do të thosha se kjo vlen për shumë lojtarë. Nëse nuk ju pëlqen planifikimi në një lojë që zgjat 7 orë, me shumë gjasa ju do ta braktisni atë fare në një lojë shahu të shpejtë. Por lojtarët më të suksesshëm - pavarësisht shpejtësisë së lojës - i mbështesin llogaritjet e tyre në planifikimin strategjik. Analizat më efektive, dhe ato më të shpejta, janë të mundura atëherë kur ka një strategji udhërrëfyese dhe të dyja nuk e përjashtojnë aspak njëra-tjetrën.

Nëse luani shah pa objektiva afatgjata, vendimet tuaja do të jenë vetëm reaguese dhe ju do të luani lojën e kundërshtarit, jo tuajën. Teksa kërceni nga diçka në një tjetër, do të dilni jashtë shinave duke u mbërthyer në atë që keni përpara, në vend të asaj që duhet të arrini.

Marrim si shembull fushatën presidenciale amerikane të vitit 1992, që i siguroi Bill Klintonit fitoren e Shtëpisë së Bardhë. Gjatë zgjedhjeve të ndërmjetme demokrate, dukej se çdo ditë, dilte nga një skandal i ri që do t'i jepte fund kandidaturës së Klintonit. Ekipi i tij i fushatës reagonte menjëherë ndaj çdo sulmi të ri, por këto nuk ishin reagime të thjeshta. Ekipi sigurohej që në çdo deklaratë për shtyp, të përcillej edhe mesazhi i kandidatit.

Në zgjedhjet e përgjithshme kundër presidentit Bush kishte një prirje të ngjashme. Ekipi i Klintonit i kundërpërgjigjej çdo sulmi duke e përqendruar sërish debatin në mesazhin e tij (prej nga doli edhe shprehja e famshme “Gjithçka ka të bëjë me ekonominë, budalla!”), dhe duke mos u shkëputur nga strategjia afatgjatë. Në të kundërt, katër vjet para Klintonit, kandidati demokrat Majkëll Dukakis, u shpërqendrua fare nga taktikat agresive të kundërshtarit. Njerëzit e dëgjonin vetëm të mbrohej ndaj sulmeve, jo të paraqiste mesazhin e tij. Në vitin 1992, ekipi i Klintonit e dinte mirë se nuk kishte rëndësi shpejtësia e përgjigjeve, por se sa i përshtateshin ato strategjisë së përgjithshme. Sidoqoftë, përpara se të ndiqni një strategji, në fillim duhet ta hartoni atë.

E ardhmja e vendimeve që merrni në të tashmen

Një strateg fillon duke caktuar një synim në të ardhmen e largët dhe operon në të tashmen për arritjen e tij. Një mjeshtër i madh bën lëvizjet më të mira, sepse mbështetet në faktin se si ai dëshiron që të duket tabela e shahut pas 10 apo 20 lëvizjesh. Kjo nuk kërkon llogaritjen e variacioneve të panumërta të 20 lëvizjeve. Mjeshtri i madh vlerëson shanset që do të ketë në një pozicion të caktuar dhe vendos objektivat. Pastaj vlerëson hap pas hapi lëvizjet për të përmbushur këto qëllime.

Objektiva të tillë të ndërmjetëm janë me rëndësi thelbësore. Ata janë përbërësit e nevojshëm që krijojnë kushtet e favorshme për strategjinë tonë. Pa to, do të ishte si të ndërtonim një shtëpi duke u nisur nga çatia. Ndodh shumë shpesh që t'i vendosim vetes një qëllim dhe të synojmë drejt tij pa marrë në konsideratë të gjithë hapat e nevojshëm për ta arritur atë. Çfarë kushtesh duhet të përmbushen që strategjia jonë të jetë e suksesshme? Çfarë sakrificash do të kërkojnë? Çfarë duhet të ndryshojë dhe çfarë duhet të bëjmë për t'i nxitur apo mundësuar këto ndryshime?

Instinkti ose analiza ime, më tregojnë se në një pozicion të caktuar, është e mundur që të sulmohet mbreti i kundërshtarit. Më pas, në vend që t'i përqendroj të gjitha forcat drejt mbretit, kërkoj objektiva që duhej të arrij për ta kryer këtë me sukses, për shembull, të dobësoj mbrojtjen rreth mbretit të kundërshtarit duke këmbyer një figurë mbrojtëse kyç. Së pari, duhet të kuptoj se cilat objektiva strategjike do të më ndihmojnë të arrij qëllimin tim për të sulmuar mbretin. Vetëm atëherë duhet të planifikoj saktësisht si t'i arrij ato dhe të kërkoj lëvizje specifike që do të më çojnë te zbatimi i suksesshëm. Nëse nuk arrini ta bëni këtë, do të përfundoni me plane të thjeshta dhe mendjeshkurtra, me pak shpresë për sukses.

Në raundin e dytë të turneut “Korus” në vitin 2001, në Holandë, u përballa me një lojtar jo të njohur, Aleksi Fedorovin, nga Bjellorusia. Ky ishte turneu më i fortë ku ai kishte marrë pjesë. Ishte hera e parë që do të ndesheshim bashkë dhe ai e bëri shpejt të qartë se nuk kishte

ndër mend të tregonte respekt për mjedisin rrethues me njerëz të respektuar dhe as për kundërshtarin.

Fedorovi e braktisi që në fillim hapjen standarde të lojës. Nëse ajo çka luajti ndaj meje do të kishte një emër, do të quhej “sulmi mes për mes”. Duke shpërfillur krejt pjesën tjetër të fushës, ai u vërsul që në fillim me të gjithë gurët e shahut drejt mbretit tim. Unë e dija se një sulm i tillë i egër dhe i papërgatitur mund të kishte sukses vetëm nëse unë bëja ndonjë gafë. Duke ruajtur mbretin, fillova të sulmoj në anën ose në krahun tjetër dhe në qendër të fushës, një zonë kritike të cilën ai e kishte lënë krejt pas dore. U bë e qartë se sulmi i tij ishte sipërfaqësor dhe ai u dorëzua pas vetëm njëzet e pesë lëvizjeve.

E pranoj se nuk duhej të bëja ndonjë gjë të veçantë për të korrur këtë fitore të lehtë. Kundërshtari im luajti pa ndonjë strategji të shëndoshë dhe përfundoi në një udhë pa krye. Fedorovi dështoi sepse nuk e pyeti veten se çfarë kushtesh duhej të përmbushte në mënyrë që sulmi i tij të kishte sukses. Ai vendosi se donte të kalonte lumin dhe hyri drejt e në ujë, në vend që të kërkonte një urë. Gjithashtu, ia vlen të theksohet se nuk është një strategji e mirë nëse mbështetesh në mundësinë që kundërshtari të kryejë një gabim serioz.

Qëndrueshmëria nuk bie në kundërshti me përshtatshmërinë

Caktimi i një qëllimi dhe i objektivave është hapi i parë. Hapi tjetër është t'i ndjekësh ato dhe të qëndrosh në vijë. Historia ushtarake është plot me raste të komandantëve që janë shpërqendruar nga veprimet në fushëbetejë, duke harruar fare strategjinë. Si na tregojnë të dhënat historike dhe Uilliam Shekspiri, forcat franceze u mundën nga anglezët në vitin 1415, në Aginkurt, kur kalorësia franceze u çorientua nga një breshëri sulmesh me shigjeta në shenjë provokimi. Kur kundërshtari i ndërlikon gjërat, ju tundoheni shumë që të kërkonit një mënyrë për të rrëzuar idenë e tij, për t'iu përveshur mëngëve dhe për t'u përballur me sfidën. Por kjo është pikërisht ajo çka do kundërshtari, prandaj duhet t'i bëni ballë shpërqendrimeve të tilla. Nëse keni vendosur një strategji të mirë, pse duhet të hiqni dorë prej saj, për të ndjekur diçka që i volitet kundërshtarit? Kjo kërkon një vetëkontroll të fortë,

sepse trysnia për të ndryshuar drejtim mund të jetë e brendshme dhe e jashtme. Egoja juaj kërkon t'i provojë kundërshtarit se mund ta mposhtni në lojën e tij, dhe kërkon të heshtë kritikët tuaj, qofshin ata aktualë apo potencialë.

Përpara ndeshjes për titullin e kampionit të botës në vitin 1993, kundër anglezit Najxhëll Short, unë së bashku me ekipin tim, vendosëm se strategjia më e mirë kundër anglezit të rrëmbyer, do të ishte nëpërmjet manovrimit të pozicioneve. Ai ishte një sulmues i rrezikshëm, i përgatitur mirë në shumë linja të mprehta loje, dhe megjithëse kjo ishte edhe pika ime më e fortë, ne menduam se unë do të kisha epërsi të konsiderueshme në lojëra më të ngadalta. Analiza jonë zbuloi sa i parehatshëm ndihej Shorti kur luante pa aktivitet.

Lojtari me gurët e bardhë të shahut kryen lëvizjen e parë dhe kjo i jep një përparësi që është e krahasueshme me lojtarin e tenisit që gjuan topin i pari. Me lëvizjen e parë, mund të kontrollosh ritmin dhe drejtimin e ndeshjes. Gjatë përgatitjeve për ndeshjet me Shortin, ne e projektuam repertorin e hapjeve me gurët e bardhë, për të qëndruar larg variacioneve të dyfishta që parapëlqente Shorti. Për këtë qëllim, unë zgjodha linja zhvillimi të ngadalta, sipas stilit të hapjes së lojtarit të nderuar Rui Lopez, mjaft i njohur për manovrat pozicionale në shah. Kjo taktikë e ka marrë emrin nga një prift spanjoll që luante shah në shekullin XVI, dhe falë efektivitetit të saj në mposhtjen e kundërshtarit, lëvizja ka marrë nofkën “tortura spanjolle”.

Unë arrita tri fitore në katër lojërat e para, duke marrë komandën e ndeshjes, që parashikonte 24 lojëra. I kisha fituar të dyja lojërat me gurët e bardhë, duke përdorur stilin e ngadaltë të manovrimit, dhe shumë veta hamendësuan se më pas do të zgjidhja variacione më agresive për të mposhtur njëherë e mirë kundërshtarin, ndërkohë që ai ndodhej në disavantazh. Sipas kësaj logjike, duke qenë se Shorti ndodhej në vështirësi, kjo ishte koha e duhur për të ndërruar marshin dhe për ta shpërqendruar atë edhe më tepër.

Unë bëra vërtet një ndryshim, por jo në strategji. E hapa lojën me një sistem krejt të ndryshëm, me lëvizje të panxituara dhe metodike që synonin të kufizonin kundërveprimin e kundërshtarit. E përdora epërsinë time për të shqyrtuar mbrojtjen e tij, duke kërkuar të gjej

pika të dobëta. Shpejt arrita edhe dy fitore të tjera duke ndjekur të njëjtën strategji të hapjeve të qeta me gurët e bardhë.

Të ndjekësh të njëjtin plan kur je në fitore, duket si diçka e lehtë, por është gjithashtu e thjeshtë të fitosh besim të tepruar në vetvete dhe, si pasojë, të të dalë ndonjë e papritur. Suksesi afatgjatë është i pamundur nëse i lejon reagimet të anashkalojnë planin që ke bërë.

Luaj lojën tënde

Dy lojtarë të fortë shahu mund të kenë strategji shumë të ndryshme në të njëjtin pozicion dhe të dyja mund të jenë njëloj efektive - duke përjashtuar këtu pozicionet ku mund të ketë vetëm një linjë të vetme fituese. Çdo lojtar ka stilin e tij, mënyrën e tij të zgjidhjes së problemeve dhe të vendimmarrjes. Çelësi i zhvillimit të strategjive të suksesshme është të jesh i vetëdijshëm për pikat e tua të forta dhe të dobëta, për të ditur se çfarë mund të bësh më mirë.

Dy shkolla të kundërta mendimi në fushën e shahut kanë nxjerrë kampionë bote. Mikhail Botvniku besonte në vetëdisiplinën e jashtëzakonshme, punën e pareshtur dhe rreptësinë shkencore. Rivali i tij Mikhail Tali mbështetej në krijimtarinë dhe fantazinë e vet, dhe nuk donte t'ia dinte shumë as për shëndetin e tij dhe as për përgatitjet metodike. Tomas Edisoni ka thënë shprehjen e famshme: “Suksesi është 1% frymëzim dhe 99% këmbëngulje”. Kjo formulë funksiononte mjaft mirë për Edisonin dhe Botvnikun, por nuk do të kishte funksionuar kurrësi për Talin, apo Aleksandër Pushkinin, themeluesin e letërsisë moderne ruse. Dashuria e Pushkinin për jetën e shfrenuar, bixhozin dhe romancën kontribuoi në aftësinë e tij për të krijuar disa nga kryeveprat më të njohura të letërsisë ruse.

Tigran Petrosiani, një tjetër ish-kampion bote, perfeksionoi artin e të ashtuquajturit “profilaksi” në shah. Profilaksia është arti i lojës parandaluese, duke fuqizuar pozicionin tënd dhe duke eliminuar para kohe kërcënimet e kundërshtarit. Petrosiani mbrohej aq mirë, sa që sulmi i kundërshtarit përfundonte që para se të niste, ndoshta edhe përpara se ai vetë ta mendonte atë. Në vend që të sulmonte, Petrosiani ndërtonte mbrojtje të shkëlqyera, duke e irrituar kundërshtarin dhe duke rritur mundësinë që ai të kryente gabime. Ai ishte vigjilent ndaj

çdo mundësie, sado e vogël, dhe i shfrytëzonte gabimet me një saktësi të pamëshirshme.

Më pëlqen ta quaj atë një “hero joaktiv” të shahut. Ai zhvilloi një taktikë të “vigilencës joaktive” që të jepte mundësinë të fitoje, pa dalë drejtpërdrejt në sulm. Në përgjithësi, strategjia e Petrosianit ishte që në fillim të kërkonte se çfarë mundësish kishte kundërshtari dhe pastaj t’i eliminonte ato. Vetëm atëherë kur pozicioni i tij ishte i pacenueshëm, ai fillonte të provonte shanset e veta. Strategjia e të qenët një objekt i palëvizshëm ishte shumë efektive për të - por shumë pak lojtarë mund të imitonin stilin e tij të duruar të mbrojtjes.

Kur luajta kundër Petrosianit në Holandë në vitin 1981, unë isha 18 vjeç, ndërsa ai 52 vjeç. Mezi prisja të hakmerresha pasi kisha humbur kundër tij në një ndeshje në fillim të vitit, në Moskë, ku kisha ndërtuar një pozicion mbresëlënës sulmi që përfundoi duke më shkaktuar humbjen. Asokohe mendova se kjo kishte qenë aksidentale, por ja që ndodhi përsëri. Sa herë që dukej sikur sulmi im ishte shkatërrues, ai qetësisht bënte nga një korrigjim të vogël. Të gjithë gurët e mi kishin rrethuar mbretin e tij dhe isha i sigurt se ishte vetëm çështje kohe derisa t’i jepja edhe goditjen e fundit. Por ajo nuk po vinte. Nisi të më dukej vetja si një dem që ndiqte toreadorin nëpër fushë. I rraskapitur dhe i irrituar, bëra një gabim dhe më vonë një tjetër, duke humbur kështu ndeshjen. Në futboll, ndodhi diçka e ngjashme një vit më vonë, në kampionatin botëror në Spanjë. Stili italian i mbrojtjes *catenaccio* triumfoi mbi stilin sulmues *jogo binito* të brazilianëve. Ndonjëherë mbrojtja më e mirë është thjesht mbrojtja më e mirë.

Përgjatë dy viteve në vijim, e barazova rezultatin duke e mundur dy herë me një stil të qetë pozicional, pothuajse si vetë stili i Petrosianit. Ky ndryshim i suksesshëm në qasje, ishte falë këshillës së Boris Spaskit, njeriut që i rrëmbeu Petrosianit titullin e kampionit të botës në vitin 1969. Përpara se të ndeshesha përsëri me Petrosianin, më pak se një vit që nga humbja që përshkrova më sipër, unë fola me Spaskin, i cili po luante në të njëjtin turne në Jugosllavi. Ai më këshilloi se çelësi ishte të ushtroja trysni, por vetëm paksa dhe në mënyrë të qëndrueshme. “Shtrydhja topet! - më tha në mënyrë të paharrueshme, - por shtrydhi vetëm njërën, jo të dyja!”

Përvoja e Spaskit ishte e ngjashme me timen. Ai u ndesh për herë të parë me Petrosianin për titullin e kampionit të botës, në vitin 1966. Gara ishte e ngushtë. Por Spaski hynte në ndeshje duke besuar gabimisht se Petrosiani nuk luante shah të mprehtë dhe sulmues, ngaqë i mungonin aftësitë për ta bërë një gjë të tillë. Spaski i ndërlikonte gjërat me çdo kusht, derisa sulmet e tij zmbropseshin me mjeshtëri nga kampioni i botës dinak.

Tre vjet më vonë, Spaski dëshmoi se kishte nxjerrë mësim nga humbja, duke treguar shumë më tepër respekt për aftësitë e Petrosianit. Në përballjen e vitit 1996, ai luajti një lojë më të baraspeshuar dhe triumfoi. Dy humbjet e para më ngjallën një respekt të thellë për aftësitë e Petrosianit dhe artin e mbrojtjes në shah. Por gjithashtu kuptova se një stil i tillë nuk bënte për mua. Unë doja të isha gjithmonë në sulm dhe këtë e reflektonin edhe strategjitë e lojërave të mia. Prandaj duhet të dini kufijtë dhe cilësitë tuaja më të mira.

Stili agresiv dhe dinamik përputhet me pikat e forta dhe personalitetin tim. Madje edhe kur jam i detyruar të mbrohem, kërkoj vazhdimisht mundësinë që ta kthej lojën dhe të kundërvihem. Edhe kur jam në sulm, nuk kënaqem me fitime modeste. Parapëlqej një shah të mprehtë dhe energjik, me gurë që fluturojnë mbi fushë dhe ku lojtari që bën gabimin e parë, humbet lojën. Lojtarë të tjerë, përfshirë Anatoli Karpovin, të cilin e munda për titullin kampion bote, luajnë duke grumbulluar avantazhe të vogla. Ata rrezikojnë paksa dhe parapëlqejnë ta përmirësojnë gradualisht pozicionin, derisa kundërshtari të mposhtet. Por të gjitha këto strategji-mbrojtëse, dinamike, manovruese - mund të jenë efektive vetëm në duart e dikujt që i kupton mirë.

Edhe në biznes, nuk ekziston ndonjë lloj strategjie që të jetë më e mira. Si ata që ndërmarrin rreziqe, ashtu edhe menaxherët konservatorë, ndodhen në majë të listës së 500 kompanive më të suksesshme të revistës "Fortune". Ndoshta 50% e vendimeve të një shefi ekzekutiv, do të merreshin në mënyrë identike nga çdo biznesmen i aftë. Në mënyrë të ngjashme, ka shumë lëvizje shahu që janë të dukshme për lojtarët e fortë, pavarësisht stilit të tyre. Diferenca ka të bëjë me 50%-in tjetër, apo 10%-in më të ndërlikuar të lëvizjeve.

Udhëheqësit më të mirë vlerësojnë çekuilibrat e veçantë dhe faktorët kyç në çdo situatë dhe ndërtojnë një strategji mbështetur mbi këtë logjikë.

Shefi ekzekutiv i kompanisë “Nokia”, Jorma Ollila, e ktheu kompaninë finlandeze në një lider të telefonisë celulare, me një stil të pazakontë, madje edhe kaotik, që e linte pa fjalë stafin në çdo kthesë. Menaxherëve të lartë iu kërkua të këmbenin rolet, stafi për kërkim-zhvillim takohej drejtpërdrejt me klientët dhe madje kryeshefi i dizajnit të celularit e krahasoi menaxhimin e kompanisë me mënyrën se si një bandë xhazi improvizon duke luajtur së bashku.

Një stil i tillë i lirshëm dhe dinamik mund të mos jetë kaq i suksesshëm në industri të tjera, ose në vende të tjera, apo me një tjetër shef ekzekutiv. Për dekada me radhë, IBM-ja e ngriti biznesin duke u mbështetur në një reputacion konservator, madje të rëndë. Kjo për shkak se kompania operonte në botën e pajisjeve të zyrave dhe për klientët e biznesit besueshmëria është shumë më e rëndësishme se stili. Modele të reja celularësh dalin çdo muaj, ndërsa IBM-ja shiste dhe ofronte për shërbim makineri, për periudha 5, madje edhe 10-vjeçare. Në sytë e klientëve, ky konservatorizëm i vërtetë është një virtyt.

Nuk mund ta përcaktosh gjithmonë fushëbetejën

Nuk mund të bëhesh dot kampion bote nëse nuk je i zoti të luash në stile të ndryshme, atëherë kur është e nevojshme. Ndonjëherë je i detyruar të luftosh në një terren me të cilin nuk je familjarizuar; sepse nuk mund të shmangesh dot kur kushtet nuk janë ato që do ti. Aftësia për t’u përshtatur është vendimtare për suksesin.

Sipas rastit, mund të ndërrosh stil për ta kapur kundërshtarin në befasi, megjithëse këtu gjithmonë ka rrezik që personi, i cili ngre kurthin, të bjerë vetë në kurth. Unë pata rezultat të mirë kur e zbatova këtë teknikë në ndeshjen e kampionatit botëror të vitit 1995, kundër yllit indian Visvanatan (Vishi) Anand, në Nju-Jork. Aty nga mesi i ndeshjeve, kur ishim barazim, pasi secili kishte fituar nga një lojë,

unë i braktisa taktikat e mia të zakonshme dhe zgjodha manovrën e frikshme me emrin “Dragoi Sicilian”, një mbrojtje që nuk e kisha përdorur më parë në një turne serioz.

Këtë lëvizje nuk e bëra në mënyrë të rastësishme. Në përzgjedhjen e Dragoit kontribuan disa faktorë. Kjo lëvizje të çon në një lojë pa kompromis, ku ti duhet të zgjedhësh vazhdimin më agresiv për të pasur mundësinë të krijosh avantazh. Anandi u befasua kur vuri re këtë lëvizje, duke hamendësuar se unë isha përgatitur shumë mirë për të. Për më tepër, kërkimet tona tregonin se Anandi kishte shumë pak përvojë me Dragoin dhe ndihej shumë më pak komod me të sesa me linjat e tjera të mprehta të hapjes. Nëse do të ndiqte variantet kryesore të rrezikshme, ishte e sigurt se do të kisha rezervuar diçka të hidhur për të. Kështu, duke qenë i paaftë të përshtatej me situatën, ai luajti butë dhe humbi dy herë.

Aftësia për t’u përshtatur sipas nevojës, i ka shërbyer mirë Napoleon Bonapartit për pjesën më të madhe të karrierës së tij legjendare. Ai njihej për surprizat në fushëbetejë, veçanërisht duke u vërsulur në mënyrë të papritur me një sulm që dukej sikur kishte ngecur në vend. Por nuk ngurronte aspak të shfrytëzonte edhe namin e tij për agresivitet, për të zënë në kurth kundërshtarin.

Napoleoni u përgatit për betejën e vitit 1805, në Austerlitz, duke i tërhequr enkas forcat e veta nga një pozicion shumë i mirë dhe duke i lejuar kështu forcat e carit rus që të depërtonin dhe të shihnin vijat e holla ushtarake franceze, teksa tërhiqeshin. Me të parë tërheqjen e tyre, cari i ri Aleksandër mendoi se ky ishte shansi i tij për lavdi dhe përgatiti një sulm të gjithanshëm, pikërisht ashtu si kishte parashikuar Napoleoni. Ky i fundit kishte sjellë fshehurazi përforcime, pikërisht në zonën ku rusët mendonin se kishte dobësi dhe forcat e carit u shpartalluan brenda ditës.

Ky nuk ishte thjesht një kurth i zgjuar që funksionoi në mënyrë të përsosur. Së pari, Napoleoni e kuptoi se kishte shumë më pak ushtarë dhe se metodat e drejtpërdrejta të luftimit nuk do të mjaftonin. Ai e dinte se kundërshtari ishte i ri, impulsiv dhe i etur për lavdi. Gjithashtu, e dinte se askush nuk do ta besonte që Napoleoni i madh do të tërhiqej me dëshirë nga një pozicion komandues. Strategjia e Napoleonit kombinoi të gjithë këta faktorë duke arritur një fitore të

shkëlqyer. Gjenerali rus me një sy, Mikhail Kutuzovi, ishte i vetmi që paralajmëroi për të pasur kujdes, por të tjerët nuk ia vunë veshin. Sidoqoftë, edhe një car mund të mësojë nga gabimet e tij. Shtatë vjet më vonë, ushtria e madhe e Napoleonit marshoi në Moskë në luftën që ne rusët e quajmë Lufta Patriotike e vitit 1812. Kësaj here, Aleksandri e dëgjoi Kutuzovin dhe ndoqi strategjinë e tij duke i provokuar trupat franceze dhe duke luajtur lojën e pritjes. Moska përfundoi duke u bërë shkumb e hi, por në fund Napoleoni u detyrua të tërhiqej.

Edhe unë isha i detyruar të përshtatesha gjatë rrugëtimit për titullin e kampionit të botës në vitin 1983. Isha një i ri 20-vjeçar që do të ndeshesha me 52-vjeçarin Viktor Korçnoi, dy herë finalist në kampionatin botëror dhe që ende vazhdon të luajë shah të fortë në moshën 75-vjeçare. Si pritej, veterani i shahut kontrollloi ritmin që në fillim të ndeshjes kualifikuese me 12 lojëra. Ai fitoi lojën e parë dhe më pengoi vazhdimisht të arrija pozicionet e hapura sulmuese që më pëlqenin.

Në vend që të vazhdoja të tensionohesha duke u përpjekur të ndryshoja karakterin e lojës, vendosa të ndiqja rrjedhën e saj. Në vend që të bëja lëvizje të mprehta që mendoja se i përshtateshin më tepër stilit tim, luajta lëvizjet më të mira që ishin të disponueshme, edhe pse ato më çonin drejt pozicioneve të qeta. Kjo më çliroi nga rëndesa psikologjike e përpjekjes për të imponuar strategjinë time në çdo lojë dhe kështu thjesht munda të luaja shah. Korçnoi më detyroi të luaja në territorin e tij, por sapo u bëra i ndërgjegjshëm për këtë, arrita të përshtatesha, të luftoja dhe të fitoja.

Kisha fituar lojën e gjashtë dhe të shtatë duke kryesuar, kur Korçnoi vendosi të përpiquej të përmbyste rezultatin. Në lojën e 9-të, ai kaloi në një stil taktik, duke dashur të më befasonte me një lojë agresive. Por pasi kishte humbur betejën në terrenin e vet, ai nuk ishte i zoti të bënte një kalim të suksesshëm në terrenin tim dhe si pasojë, përfundoi duke humbur. Përvoja e përshtatjes nën tryzni më ndihmoi shumë kur duhej të bëja të njëjtën gjë në kushte edhe më pak të favorshme në ndeshjen kundër Karpovit, në betejën e kampionatit botëror, një vit më vonë.

Siç e dinë të gjithë lexuesit e Darvinit, dështimi për t'u përshtatur, sjell gjithmonë pasoja të tmerrshme. Një shembull klasik vjen nga

historia e Amerikës, kur Xhorxh Uashingtoni ishte një vullnetar në një kamp ndihme, duke luftuar me ushtrinë britanike kundër forcave franceze dhe indigjene. Britanikët nuk bënë thujtje asnjë përpjekje për t'u përshtatur në frontin e luftës të vendosur nga armiqët. Gjenerali Eduard Bredok ishte një rast tipik tragjik. Ai i rreshtonte uniformat e kuqe në radhë të rregullta në fushë të hapur, duke goditur me breshëri të mirorganizuara në pyje, ndërsa snajperët francezë dhe indianë godisnin nga pozicione të fshehta. Vetëm kur Bredok përfundoi i vrarë në një betejë shkatërrimtare, ushtarët e mbetur, më në fund mundën të tërhiqeshin, nën udhëheqjen e vetë Xhorxh Uashingtonit.

Një tjetër histori jo aq fatkeqe është ajo e “Encyclopaedia Britannica”, kur ajo u ballafaqua me epokën e kompjuterëve. Megjithëse është ndoshta emri më i përmendur në librat e referencës, gafa e saj e parë ishte se ofroi me shumë vonesë produktet në versionin CD-ROM. Në fund të fundit, kush do të donte të zëvendësonte gjithë ata libra të bukur me një version kompjuterik? Gjithkush, siç e dimë tashmë të gjithë. Kjo bëri që enciklopedia digjitale “Microsoft Encarta” dhe të tjerë, të merrnin një përqindje shumë të madhe të tregut, ndërkohë që shitjet e enciklopedive të shtypura ranë ndjeshëm.

Më vonë erdhi Interneti dhe premtimi për një numër klientësh thujtje të pakufizuar në mbarë botën. “Britannica” i ngarkonte klientëve tarifë për përdorimin e saj, në një kohë kur të tjerët e ofronin përmbajtjen e tyre falas dhe kuptohet që biznesi i kompanisë ishte i dobët. Pak vite më vonë, kishte shpërthyer tashmë buma i dot-com, diçka që e kujtoj mjaft mirë nga përvoja ime me portalin e shahut. Tregu i reklamave u përmbys plotësisht kur më në fund, “Britannica” vendosi të mundësonte qasje pa pagesë. Në çdo veprim që ndërmorën, ata ishin në anën e gabuar të ndryshimit.

Cili ishte shkaku i dështimeve të njëpasnjëshme të “Britannica”-s? Ata mbetën dukshëm mbrapa në procesin e kalimit nga media e shtypur në atë digjitale. Dështimi i strategjive të tyre në lidhje me Internetin është shumë më i ndërlikuar. Të jesh shumë përpara në krahasim me mjedisin rrethues, mund të jetë po aq e keqe sa të mbetesh mbrapa kundërshtarëve. Në vend që të mbështeteshin në përparësinë e madhe të emrit, ata u përpoqën të tejkalojnë një treg të ri të paparashikueshëm, duke pësuar humbje në çdo përpjekje.

Një strategji që ndryshon përherë, është e njëjta gjë me mungesën e strategjisë

Ndryshimi është themelor, por ai duhet të ndërmerret duke u menduar me shumë kujdes dhe duke pasur një arsye të shëndoshë. Humbja mund t'ju bindë që të ndryshoni diçka që nuk është e nevojshme të ndryshohet dhe fitorja mund t'ju mbushë mendjen se çdo gjë po shkon vaj në një kohë kur mund të ndodheni në prag të rrënimit. Nëse nxitoni duke fajësuar menjëherë strategjinë e gabuar dhe e ndryshoni atë gjatë gjithë kohës, kjo do të thotë se ju në të vërtetë, nuk keni asnjë strategji. Vetëm atëherë kur rrethanat ndryshojnë në mënyrë radikale, duhet të merrni parasysh një ndryshim thelbësor.

Ne duhet të ruajmë baraspeshën midis fleksibilitetit dhe vazhdimësisë. Një strategji duhet të ketë besim te strategjia e tij, të ketë guximin për ta ndjekur atë dhe në të njëjtën kohë, të jetë mjaftueshëm mendjehapur për të kuptuar se kur duhet ndryshuar drejtim. Ndryshimet duhet të mendohen me shumë kujdes dhe kur ndërmerren, ato duhen bërë me vendosmëri. Zakonisht, suksesi nuk analizohet aq shumë sa dështimi dhe prandaj, në rast fitoresh, ne ia japim meritën epërsisë sonë, në vend të rrethanave. Kur gjërat shkojnë mirë, është edhe më e rëndësishme të bëni pyetje. Besimi i tepërt në vetvete çon në gabime, duke krijuar ndjesinë se çdo gjë po shkon vaj.

Në një nga ndeshjet më të tensionuara të jetës sime, kundërshtari nuk kishte besim në planet e tij. Në vitin 1985, po ndeshesha me kundërshtarin tim prej kohësh, Anatoli Karpovin. Ishte loja finale e përballjes sonë të dytë për titullin kampion bote dhe unë kryesoja me një pikë të vetme. Ai kishte përparësinë se luante me gurët e bardhë dhe nëse fitonte, do të arrinte të barazonte duke mbajtur në këtë mënyrë titullin e kampionit për tre vitet e ardhshme.

Karpovi luajti që në fillim me agresivitet dhe ndërtoi një pozicion sulmi mbresëlënës kundër mbretit tim. Më pas, erdhi çasti kur duhej marrë vendimi kritik, nëse duhej të qëndronte besnik ndaj strategjisë fillestare të sulmit duke i çuar ushtarët përpara drejt anës time të mbretit, apo nëse duhej të bënte përgatitje më të kujdesshme. Mendoj se të dy e dinim që ky ishte momenti më kritik i ndeshjes.

Karpovi vendosi të mos përparonte me ushtarët dhe kështu i shpëtoi mundësia nga duart. Pasi kishte shpenzuar njëzet lëvizje